REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më ____.____.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr._____date._____._____. 2025

PER MIRATIMIN E FONDIT PER SHTESE KAPITALI PER F.C BESA SH.A

Ne mbledhjen e tij te dates . .2025, me propozim te Kryetarit te Bashkise, mbeshtetur ne nenin 9 pika i.3 shkronja "c", 34, 40, 41, 54 shkronja "dh" te ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 te ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar, ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin"te ndryshuar; Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 23 date 30.07.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV", Udhezimi nr.08 date 28.02.2025''Per pergatitjen e PBA 2026-2028''Shkresa nr.4074/1 dt.04.03.2025 ''Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028,Parashikimet e Transfertave te Pakushtezuar te Pergjithsshme dhe Sektoriale''Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar,VKB nr.68 date 23.12.2024 ''Mbi miratimin e Buxhetit vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027'' VKB 06 date 25.02.2025 ''Ndryshim ne VKB nr.68 date 23.12.2024 '' ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne Ligjin nr.79/2017 "Per Sportin ",i ndryshuar me Ligjin Nr.105/2020 si shtese ne kapitalin e aksionerit Bashkia Kavaje dhe Relacionit te Administrates se Bashkise Kavaje,Drejtorise se Kultures dhe Sporteve.

I PROPOZON:

1. Keshillit Bashkiak te miratoje akordimin e fondit per shtese kapitali per Futboll Club Besa Sh.A ne vleren 73,000,000 leke

1. Pjesë e ketij vendimi eshte dhe dokumentacioni shoqerues (Relacioni) i cili perfshin informacion te detajuar sipas programeve dhe klasifikimeve buxhetore te Njesise se Veteqeverisjes Vendore.

2. Ky vendim hyn ne fuqi sipas percaktimeve te pikes 6 te nenit 55 te ligjit 139/2015 "*Per veteqeverisjen vendore*" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni Prefektit te Qarkut Tirane.

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE
SEKRETARI I GMS

ALBI LUSHKA

DREJTORIA LIGJORE

HELIDON PLAKU

DREJTORIA E KULTURES, TRASHEGIMISE KULTURORE DHE SPORTIT

GENTIAN JAUPI

SEKRETARI I PERGJITHSHEM
KOORDINATOR I GMS

ADRIAN MALAJ

SEKRETAR I KESHILLIT

MERI BITURKU

K R Y E T A R I

P/ **FISNIK QOSJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KAVAJË

Nr. Prot

Kavajë, me____.____.2025

RELACION

Shtese Kapitali per ''Futboll Club BESA''

Tetor 2025

- **Kuadri ligjor**

  - Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
  - Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
  - Ligji nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
  - Ligji nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
  - Ligji nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
  - Ligji nr. 9869/2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore;
  - Ligji nr.9901 date 14.04.2008 ''Per tregtaret dhe shoqerite tregtare''
  - Ligji nr.79/2017 ''Per sportin'',i ndryshuar me Ligjin nr.105/2020

  - Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.
  - Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.
  - Udhezimi nr.3 date 28.02.2024 ''Per Pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027'' me shtojcat plotesuese
  - Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr.08 date 05.07.2024 ''Per Pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027''
  - Ligje dhe akte nënligjore të tjera.
  - Shkreses se Ministrise se Financave nr.14488 prot. Date 29.10.2024 ''Dergohet per njoftim Transferta e Pakushtezuar e Pergjithsshme dhe Sektoriale per Vitin 2025''

1. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
5. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Relacion mbi Buxhetin

I. Objekti i relacionit

Ky relacion ka për qëllim të paraqesë arsyetimin dhe bazën ligjore për akordimin e një fondi financiar për mbështetjen e klubit të futbollit FC Besa Kavajë nga buxheti i Bashkisë Kavajë për sezonin futbollistik 2025–2026. Mbështetja financiare synon të ndihmojë në përmbushjen e nevojave të klubit për pjesëmarrjen në kampionatet kombëtare, për zhvillimin e sportit në nivel vendor dhe për përfshirjen e të rinjve në veprimtari sportive.

II. Baza ligjore

Akordimi i fondeve nga buxheti vendor për veprimtari sportive bazohet në dispozitat ligjore në fuqi, si:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Kavajë nr. 68, datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit Vjetor 2025 të Bashkisë Kavajë";
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Kavajë nr. 06, datë 25.02.2025 "Për shtesën mbi Buxhetin 2025 të Bashkisë Kavajë"
- Ligjin Nr 79/2017 "Per Sportin" i ndryshuar me Ligjin nr.105/2020

III. Argumentimi dhe nevoja për mbështetje

Klubi i futbollit FC Besa Kavajë është një nga strukturat më të rëndësishme sportive në qytet, me një histori të gjatë dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet, veçanërisht në përfshirjen e të rinjve dhe promovimin e qytetit në nivel kombëtar.

Aktualisht, klubi përballet me sfida financiare që përfshijnë:
- Shpenzimet për pjesëmarrje në kampionat;
- Pagesën e trajnerëve dhe stafit teknik;
- Qiramarrjen e stadiumit te liçensuar te qyteteve prane Kavajes per zhvillimin e ndeshjeve ne kuader te Kampionatit Kombetar
- Aktivitetet e moshave të reja.

Bashkia Kavajë, si institucion lokal, ka interes të drejtpërdrejtë në ruajtjen dhe zhvillimin e këtij institucioni sportiv, si pjesë e identitetit qytetar dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së banorëve.

IV. Fondi i propozuar

Nga analiza e paraqitur nga drejtuesit e klubit dhe nga shqyrtimi i mundësive buxhetore të

bashkisë, propozohet akordimi i një fondi prej 73,000,000 lekësh për sezonin futbollistik 2025–2026, i cili do të përdoret për:

1. Shpenzime operacionale të ekipit të parë;
2. Mbështetje për akademinë e moshave të reja;
3. Shpenzime operative te Klubit gjate zhvillimit te ndeshjeve zyrtare .

Buxheti i Bashkise Kavaje si Njesi Shpenzuese,nepermjet Programit Sport dhe Argetim 08130, ne te cilin do te transferohet fondi ne llogarine 603(subvencione) nga Programi Planifikim,Menaxhim dhe Administrim 01110,ne llogarine 602(Shpenzime Korrente),ne kapitullin 05(Te Ardhurat e Bashkise),ne vleren 73,000,000 leke,te cilat jane buxhetuar ne programin kryesor te Bashkise per faktin e realizimit mbi parashikimin,te miratuar me VKB nr.06 date 25.02.2025 "Nje shtese mbi Buxhetin vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027'' ne Pasqyren nr.3(Shpenzime Operative),me burime financime ne kapitullin 05 ne vleren 273,404,684 leke dhe te parashikuara ne vleren 73,000,000 leke per financim si shtese Kapitali per FC Besa po ja propozojme organit te Keshillit Bashkiak per t'a miratuar vleren perkatese.

Fondet do të disbursohen sipas një marrëveshjeje bashkëpunimi dhe me raportim financiar periodik sipas rregullave të menaxhimit financiar publik.

V. Konkluzion dhe rekomandim

Në përputhje me sa më sipër, rekomandohet:

- Miratimi nga Këshilli Bashkiak i fondit të propozuar për FC Besa Kavajë;
- Nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Bashkisë dhe klubit;
- Raportim i rregullt mbi përdorimin e fondeve dhe rezultatet e arritura.

Rishperndarjen e fondeve ne Palanifikim,Menaxhim dhe Administrim ne Programin Sport dhe Argetim;

Emertimi	*Kap.*	*Zeri*	*Pakesohet /leke:*	*Shtohet /leke :*
Planifikim,Menaxhim dhe Administrim				
	05	602	73,000,000	
Programi Sport dhe Argetim				
	05	603		73,000,000
Shuma			**73,000,000**	**73,000,000**

Përgatiti:
Erdi Berati,Pergjegjes i Sektorit te Buxhetit

FUTBOLL CLUB BESA sh.a

VENDIM

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE TË

FUTBOLL KLUB "BESA" SH.A.

OBJEKTI:
Shtesë kapitali për Futboll Klub "Besa" Sh.A.

BAZA LIGJORE:

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;

- Statuti i Shoqërisë "Futboll Klub Besa" Sh.A.;

- Vendimi i Asamblese se Pergjithshshme te Aksionareve "Për miratimin e shtesës së kapitalit në shoqërinë aksionare Futboll Klub Besa Sh.A.''

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE,
Pas shqyrtimit të nevojës për shtesë kapitali, me qëllim mbështetjen financiare dhe zhvillimin e veprimtarisë sportive të shoqërisë,

VENDOSI:
Të miratohet shtesa e kapitalit themeltar të shoqërisë "Futboll Klub Besa" Sh.A., në shumën prej 73,000,000 leke
Shtesa kapitalit do të realizohet nëpërmjet kontributit financiar të aksionarit "Bashkia Kavajë", ne Buxhetin Vjetor te vitit 2025,te miratuar me VKB nr.68 date 23.12.2024
Pas realizimit të shtesës së kapitalit, Administratori ngarkohet me administrimin e shpenzimeve nen kujdesin e Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve.
Administratori i shoqërisë ngarkohet për depozitimin e ndryshimeve përkatëse pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme ligjore dhe procedurale.

ADMINISTRATORI

SHPETIM BIZHDILI

Nr. 09/25 prot.

Kavajë, më 21/07/2025

VENDIM
Nr. 09/25, datë 21/07/2025

PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQERISË AKSIONARE
FUTBOLL CLUB BESA, *ME AKTIVET E SAJ*

Nga përmbajtja procesverbalit datë 21 Korrik 2025, të mbledhjes Asamblesë Përgjithshme të *Shoqërisë* Aksionare FUTBOLL CLUB BESA, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K53107801A,
me seli në Tiranë, Kavajë, Rruga "TAULANTIA", Stadiumi "BESA";
me objekt veprimtarie: "Zhvillimi veprimtarise ne Sportin e Futbollit Profesionist si anëtare e Federatës Shqiptare te Futbollit. Përqatitja e lojtarëve profesionistë, shitja dhe blerja e lojrave dhe zhvillimin e çdo aktiviteti sportiv ne funksion të arritjes së qëllimit për të cilin është krijuar. Zhvillimi veprimtarisë në Sportin e Futbollit...etj."
me pjesmarjen e Aksionarëve zot *ërues të* Kapitalit nënshkruar të Shoqërisë Aksionare më 31 Dhjetor 2024, me *kuorumin e nevojshëm për marjen e vendimeve*, prov *uar nga* Ekstrakti Historik lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit; *sa vijon :*

Iloji i kontributit në lekë Al*;*

- *Kapitali lekë Al i shlyer plotësisht* *160,000,000*
- numri aksioneve të zakonshme 160,000
- vlera nominale e një aksioni lekë Al 1,000
- *përqindja e pjesmarjes në kapitalin e shoqërisë* *100 %*

Me pjesmarjen e Aksionarëve:

1.1. **Aksionari Bashkia Kavajë:**
Iloji i kontributit lekë Al*;*

- *Kapitali në lekë Al i shlyer plotësisht* *60,260,000*
- numri aksioneve me të drejtë vote 60,*260*
- vlera nominale e një aksioni lekë 1,000
- *përqindja e pjesmarjes të kapitalit të shoqërisë* *37 %*

1.2.**Aksionari Shpëtim Bishdili:**

- *Kapitali në lekë Al i shlyer plotësisht* *99,740,000*
- numri aksioneve me të drejtë vote 99,*740*
- vlera nominale e një aksioni lekë 1,000
- *përqindja e pjesmarjes në kapitalin e shoqërisë* *63 %*

me kërkesën e Administratorëve për :

Zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë Aksionare FUTBOLL CLUB BESA, me aktivet e Saj, Asambleja Përgjithshme, bazuar në dokumentacionin e paraqitur ;

- Raportet e administratorëve për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë,
- Pasqyrat Financiare e shënimet Spjeguese datë 31 Dhjetor 2024,
- Ekstraktin Historik të lëshuar nga Qendrën Kombëtare të Biznesit,
- Raporti Audituesit ligjor për kontrollin e operacioneve të kryera për zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë Aksionare FUTBOLL CLUB BESA,
- Deklaratën e Administratorëve ;

me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë të Shoqërisë në të ardhmen, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar e Statutin e Shoqerisë; Asambleja Përgjithshme e Shoqërisë, ka

VENDOSUR

Zmadhimin e kapitalit aksionar të Shoqërisë Aksionare Futboll Club BESA Kavajë *me aktivet e saj,* sa vijon:

1. Kapitali i Shoqërisë Aksionare Futboll Club BESA Sha, më 31 Dhjetor 2024,

para marjes së vendimit për zmadhimin e kapitalit, prov*uar nga* Ekstrakti Historik të lëshuar nga Qendrën Kombëtare të Biznesit, Pasqyrat Financiare datë 31 Dhjetor 2024 dhe Raportit të Audituesve Ligjorë i*shte :*

- Iloji i kontributit në lekë Al*;*
- *Kapitali lekë Al* *160,000,000 i shlyer plotësisht;*
- numri aksioneve 160,000;
- vlera nominale e një aksioni lekë Al 1,000;
- *përqindja e pjesmarjes* *100 % të kapitalit të shoqërisë.*

Me pjesmarjen e Aksionarëve:

Aksionari Bashkia Kavajë:

- Iloji i kontributit lekë Al*;*
- *Kapitali në lekë Al* *60,260,000 i shlyer plotësisht;*
- numri aksioneve me të drejtë vote 60*,260*;
- vlera nominale e një aksioni lekë 1,000;
- *përqindja e pjesmarjes* *37 % të kapitalit të shoqërisë.*

1.2. Aksionari Shpëtim Bishdili:

- *Kapitali në lekë Al* *99,740,000 i shlyer plotësisht;*
- numri aksioneve me të drejtë vote 99*,740*;
- vlera nominale e një aksioni lekë 1,000;
- *përqindja e pjesmarjes* *63 % të kapitalit të shoqërisë.*

2. **Për Vitin 2024, Kapitali i Shoqërisë Aksionare Futboll Club BESA, zmadhohet me aktivet e Saj në shumën lekë Al 18,000,000 dhe humbjet e Shoqërisë ulen me shumën lekë Al 36,000,000 me kontributin e Aksionarëve:**

2.1. Aksionari Bashkia Kavajë:

Financimi shumës lekë Al 18,000,000 lekë (donacione) kryer nga Bashkia Kavajë në Vitin 2024 (bazuar në transaksionet bankare të kryera në periudhën 1 Janar 2024 deri 31 Dhjetor 2024)

Kalojnë Kontribut i Aksionarit në uljen e humbjeve të mbartura të Shoqërisë Aksionare Futboll Club BESA.

2.2. Aksionari Shpëtim Bishdili:

Nga Kapitali zotëruar nga Aksionari Shpëtim Bishdili më 31 Dhjetor 2024, zbritet shuma lekë Al 18,000,000, kontribut i Aksionarit që kalojnë për uljen e humbjeve të mbartura të Shoqërisë Aksionare Futboll Club BESA.

3. **Kapitali i Shoqërisë Aksionare Futboll Club BESA Sha, më 31 Dhjetor 2024, pas zmadhimit me aktivet e Saj, pasqyrohet në regjistrat kontabël të Shoqërisë e në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me t*ë dhënat:***

- Iloji i kontributit në lekë Al*;*
- *Kapitali lekë Al* *1 42,000,000 i shlyer plotësisht;*
- **numri aksioneve** **142,000;**
- **vlera nominale e një aksioni lekë Al** **1,000;**
- *përqindja e pjesmarjes* *100 % të kapitalit të shoqërisë.*

Me pjesmarjen e Aksionarëve:

3.1. Aksionari Bashkia Kavajë:

- Iloji i kontributit lekë Al*;*
- *Kapitali në lekë Al* *60,260,000 i shlyer plotësisht;*
- **numri aksioneve me të drejtë vote** **60,*260*;**
- **vlera nominale e një aksioni lekë** **1,000;**
- *përqindja e pjesmarjes* *42 % të kapitalit të shoqërisë.*

3.2. **Aksionari Shpëtim Bishdili:**

- *Kapitali në lekë Al* *81,740,000 i shlyer plotësisht;*
- **numri aksioneve me të drejtë vote** **81,*740*;**
- **vlera nominale e një aksioni lekë** **1,000;**
- *përqindja e pjesmarjes* *58 % të kapitalit të shoqërisë.*

4. Miratimin e Raporteve të për kontrollin e operacioneve të kryera për zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë FUTBOLL CLUB BESA Sha me kapitalet e veta dhe dhe ndryshimet në zërin e kapitalit të Shoqërise, hartuar nga Audituesit Ligjor Sherife Hoxha, liçencuar nga IEKA me Nr. 338 datë 28.03.2014, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NUIS K71906025P.

Ky vendim regjistrohet në Regjistrin e Vendimeve të Shoqërisë, i cili nuk munc të fshihet.

Ngarkohen Administratorët e Shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi e dokumentacionin kërkuar ligjor pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, publikimin e vendimit dhe kryerjen e veprimeve në regjistrat përkatës dhe kontabilitetin e Shoqërisë.

ADMINISTRATORI
SHPETIM BIZHDILI

FUTBOLL CLUB BESA SH.A

KERKESE-RELACION

Për propozimin e fondit prej 73,000,000 lekësh nga Buxheti i Bashkisë Kavajë për Klubin e Futbollit 'Besa' për vitin 2025.

1. Qëllimi i kerkese-relacionit

Ky relacion ka për qëllim të argumentojë propozimin për akordimin e fondit prej 73,000,000 (shtatëdhjetë e tre milionë) lekësh nga Buxheti i Bashkisë Kavajë për mbështetjen e Klubit të Futbollit 'Besa' gjatë sezonit 2025-2026. Ky fond synon të mbështesë zhvillimin e aktivitetit sportiv, përmirësimin e infrastrukturës, dhe promovimin e vlerave sportive në komunitet.

2. Situata aktuale e klubit

Klubi i Futbollit 'Besa' përfaqëson një ndër asetet më të rëndësishme sportive të qytetit të Kavajës. Klubi përballet me sfida financiare për shkak të rritjes së kostove operative dhe nevojës për ngjitjen ne Superlige. Aktualisht, klubi financohet pjesërisht nga Bashkia dhe nga Presidenti, por fondet ekzistuese nuk mjaftojnë për mbulimin e plotë të shpenzimeve të planifikuara.

3. Pse pikerisht 73,000,000 leke?

Fondi prej 73,000,000 lekësh do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve operative, përmirësimin e kushteve të trajnimit, mirëmbajtjen e terreneve sportive. Kjo mbështetje është e nevojshme për ruajtjen e performancës së ekipit, rritjen e pjesëmarrjes rinore me ekipet e grupmoshave te akademise BESA dhe përmirësimin e imazhit të qytetit përmes sportit.

4. Përdorimi i fondeve të propozuara

Kategoria e shpenzimit	Shuma (lekë)	Përshkrimi
Shpenzime operative (transport, stërvitje, uniforma,paga,shperblime)	40,000,000	Për aktivitetet e përditshme të klubit
Pajisje dhe materiale sportive	10,000,000	Topa, uniforma, pajisje trajnimi
Mirëmbajtje aneksit stervitor	8,000,000	Ndriçim, pastrim, siguri
Përmirësim infrastrukture klubit	5,000,000	Mirembajtje e ambienteve të brendshme
Rezervë për kontingjenca	5,000,000	Shpenzime të paparashikuara
Detyrimet e Shoqerise Aksionere ndaj DPT dhe FSHF	5,000,000	Pjesëmarrje në aktivitetet e FSHF-së dhe plotesimin e standarteve financiare sipas UEFA-s dhe FIFA-s

Totali: 73,000,000 lekë.

Ekzekutimi I fondit

Përdorimi i fondit do të monitorohet në mënyrë të rregullt nga Bashkia Kavajë përmes raportimeve tremujore dhe auditimeve të brendshme. Klubi do të jetë i detyruar të paraqesë raporte financiare dhe të publikojë të dhënat e shpenzimeve ne varesi te performances qe do kete ne Kampionatin Kombetar te Futbollit(Kategoria e I)

6. Përfundime dhe propozim

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e aktivitetit sportiv dhe rolin e Klubit të Futbollit 'Besa' në komunitetin e Kavajës, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë fondin prej 73,000,000 lekësh për vitin 2025, në mënyrë që të garantohet funksionimi, zhvillimi dhe suksesi i klubit.